



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KRYETARI

Nr. 4378 prot.

Tiranë, më 26, 1, 2019

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

ZOTIT ALDRIN DALIPI
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

TIRANË


I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur do të gjeni për shqyrtim dhe miratim relacionin dhe projekt-vendimin “Për një shtesë në vendimin nr. 49, datë 11.11.2015 , të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e kritereve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës, të ndryshuar”.

Me respekt,

KRYETARI

Erion VELIAJ



RELACION

“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 49, DATË 11.11.2015 “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRCAKTIMIT TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE NËNZONAVE TË DESTINUARA PËR PARKIM, SI DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT TË ADMINISTRUARA NGA BASHKIA E TIRANËS”, TË NDRYSHUAR ”

Këshilli Bashkiak, me anë të vendimit nr. 48 datë 11.11.2015 ka krijuar Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë, dhe ku njëra prej detyrave të saj funksionale është edhe vjelja e tarifave të këtij shërbimi.

Referuar memos me nr.prot.34248/1, datë 10.10.2018 (bashkëlidhur) si dhe informacionit të përcjellë nga Tirana Parking aktualisht vjelja e tarifës së parkimit kryhet me anë të dy metodave:

Me anë të platformës SMS payment, në 35 rrugë me sistem tarifimi

Me anë të platformës SMS payment dhe biletës fizike njëkohësisht, në 13 rrugë me sistem tarifimi.

Struktura përkatëse e këtij institucioni, Drejtoria e Administrimit të Shërbimit të Parkimit me Pagesë, nga verifikimet rutinë të kryera në të gjitha rrugët me sistem tarifimi, ka konstatuar se në rrugët e administruara vetëm me anë të platformës SMS Payment, ka mungesa në kryerjen e pagesës nga individë të ndryshëm që përdorin këtë shërbim.

Me shkresën me nr. 34248 prot., datë 17.09.2018, Tirana Parking ka informuar se gjatë punës së saj të përditshme ka patur ankesa verbale, ankesa në numrin zyrtar të telefonit të institucionit, në rrjetet sociale dhe në e-mailin zyrtar tiranaparking@tirana.al, se në rrugët të cilat janë me sistem tarifimi dhe ku pagesa kryhet vetëm me anë të platformës SMS Payment, duhet të ketë një metodë tjetër alternative për kryerjen e pagesës së shërbimit të parkimit.

Ky konkluzion është arritur për arsytet se jo të gjithë qytetarët kanë mundësinë për të patur kredit të mjaftueshëm në mjetet celulare për kryerjen e kësaj pagese. Gjithashtu, ankesa dhe kërkesa për përfshirjen e një metode tjetër alternative për kryerjen e pagesës së shërbimit të parkimit ka patur edhe nga qytetarë të cilët nuk disponojnë një numër telefoni të një kompanie shqiptare dhe në këtë mënyrë kanë hasur vështirësi për kryerjen e pagesës dhe si rezultat janë penalizuar, shpeshherë edhe me masa administrative (gjyba) nga organet kompetente.

Bashkia e Tiranës për një menaxhim sa më efikas të vjeljes së të ardhurave po shqyrton mundësinë e shtimit të një metode tjetër alternative e cila konsiston vendosjen e pajisjeve vetëshërbyese në vendet e destinuara për parkim të cilat mund të punojnë gjatë periudhës kur shërbimi i parkimit është aktiv dhe që përbën një metodë të thjeshtë dhe efektive për verifikimin e tarifës së parkimit nga struktura përgjegjëse e Bashkisë Tiranë. Për realizimin e këtij shërbimi shoqëria përfituese do të përfitojë një komision i cili do të kryhet nga qytetarët që përfitojnë nga shërbimi i parkimit publik.

Për këtë qëllim, për një menaxhim sa më efikas të vjeljes së të ardhurave në rrugët me metodën SMS Payment, për të shmangur pakënaqësitë e qytetarëve për mungesën e një metode alternative për kryerjen e pagesës së shërbimit të parkimit, si dhe për t’iu bashkuar nismave të tjera të Bashkisë Tiranë për promovimin e risive inovative për kryerjen e pagesave, Tirana Parking, propozon shtimin e një metode alternative për këtë shërbim. Por mbi të gjitha, në shumicën e rasteve nga ana e inspektorëve të Tirana Parking është

konstatuar që në një pjesë të mirë të rrugëve të destinuara për shfrytëzimin e hapësirës publike nëpërmjet parkimit të mjeteve me pagesë, shmanget pagesa e tarifës së parkimit, për shkak të mungesës së alternativës së kryerjes së pagesës. Ky konstatim përben një ndër problemet dhe qëllimet kryesore që ka vetë Tirana Parking në ofrimin e shërbimit të parkimit në qytetin e Tiranës dhe ofrimin e disa alternativave në mënyrën e kryerjes së pagesave. Një ndër synimet e tjera është edhe shmangie e kryerjes së tarifës së parkimit me lekë në dorë nga pronari i mjetit te inspektori i Tirana Parkimit, duke synuar shmangien e çdo abuzimi të mundshëm dhe kontaktit nëpërmjet inspektorit dhe paguesit të tarifës, në këtë rast shfrytëzuesi i hapësirës publike.

Për këtë arsye, me shkresën 37784, datë 11.10.2018 (bashkëlidhur) Bashkia Tiranë në kuadër të bashkëpunimit institucional i është drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik nëse shërbimi i sipërpërmendur është objekt i zbatimit të procedurave të prokurimit publik. Institucioni i lartpërmendur, me shkresën me nr.prot.9778/1, datë 25.10.2018 (bashkëlidhur) ka informuar se meqënëse pagesa do të kryhet nga qytetarët dhe jo nga buxheti i Bashkisë, nuk kemi të bëjmë me përdorim të fondit publik në kuptim të nenit 3 pikat 1 dhe 4 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Për sa më sipër, duke marrë parasysh të ardhurat të cilat do të gjenerohen në buxhetin e Bashkisë së Tiranës nga përdorimi i këtij opsioni efektiv i propozojmë Këshillit Bashkiak në cilësinë e organit vendimarrës të miratojë “Për një shtesë në vendimin nr. 49, datë 11.11.2015 “Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës”, të ndryshuar.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana juaj,

Znj. Ornela Kurti

Specialist i Sektorit të Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit




Znj. Enola Bejko

Përgjegjëse, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit, Drejtoria Juridike

Znj. Laura Deliu

Drejtor, Drejtoria Juridike




Znj. Eglantina Zere

Drejtor i Përgjithshëm, Tirana Parking

Z. Alban Dokushi

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit



Z. Taulant Tusha

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike

Znj. Jonida Halili

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

Z. Arbjan Mazniku

Zv/Kryetar i Bashkisë Tiranë

Znj. Esmeralda Demiraj

Përgjegjëse i Këshillit Bashkiak

Z. Behar Zeneli

Sekretar i Këshillit Bashkiak



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKË E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

**“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 49, DATË 11.11.2015, TË KËSHILLIT
BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRCAKTIMIT TË
ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE NËNZONAVE TË
DESTINUARA PËR PARKIM, SI DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË
PARKIMIT TË ADMINISTRUARA NGA BASHKIA E TIRANËS, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje nenit 113, pika 2 të ligjit 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 8, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 6 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 7, pika 1, shkronjat “e” dhe “f”, pikat 8, 10 e 11 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe bazuar në memon me nr. prot. 34248/1, datë 10.10.2018, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 49, datë 11.11.2015, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuar për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës”, të ndryshuar, behet kjo shtesë, si më poshtë:

1. Në pikën 5, pas fjalisë së parë, shtohet paragrafi si më poshtë:

“Tarifa e shërbimit të parkimit të administruar nga Bashkia e Tiranës mund të bëhet pranë punonjësve të Tirana Parking ose nëpërmjet mënyrave alternative të pagesës, sipas marrëveshjeve të lidhura midis Bashkisë së Tiranës dhe subjekteve që ofrojnë metoda alternative pagese. Në rastin kur tarifa e shërbimit të parkimit kryhet nëpërmjet alternativave të tjera të pagesave, komisioni që i mbahet përfituesit për shërbimin e ofruar, përcaktohet në marrëveshjen e lidhur midis subjektit privat dhe Bashkisë Tiranë. Bashkia e Tiranës ofron të gjithë transparencën e nevojshme për pagesën e shërbimit të parkimit dhe komisionet përkatëse që mbahen nëpërmjet metodave alternative të pagesës”.


2. Autorizohet Tirana Parkim për të ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme konkurruese, përzgjedhëse dhe nënshkrimin e marrëveshjeve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Tirana Parking për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E VERIFIKIMIT

Nr. 9246 Prot.

Tiranë, më 25.10 .2018

Lënda: Kthim përgjigje

BASHKISË TIRANË

Adresa: Adresa: Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Tiranë.

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") mori në shqyrtim shkresën tuaj Nr. 37784 Prot., datë 11.10.2018, me objekt "Dhënie opinionimi ligjor".

Nga shkresa e dërguar kuptojmë se, aktualisht institucioni juaj ka përcaktuar Tirana Parking, si strukturën përgjegjëse për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë dhe vjeljen e tarifave për këtë shërbim, nëpërmjet biletës fizike dhe platformës sms payment.

Gjithashtu, nga shkresa e dërguar rezulton se, nga ana juaj po shqyrtohet mundësia e vendosjes së pajisjeve vetshërbyese në vendet e destinuara për parkim, si një metodë alternative pagese për këtë shërbim. Në kushtet kur, një ndër shoqëritë që e ofron këtë shërbim alternativ pagese, kërkon të mbajë një komision shërbimi nga pagesa që kryhet nga qytetarët që përfitojnë nga shërbimi i parkimit publik, kërkohet mendim nëse ky shërbim duhet të jetë objekt i zbatimit të procedurave të prokurimit publik, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Lidhur me sa keni kërkuar në shkresën tuaj sqarojmë se, në nenin 3, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se:

"Procedurat përzgjedhëse të prokurimit" janë procedurat e ndërmarra nga autoritetet kontraktore për përzgjedhjen e fituesve për kontratat publike për mallra, punë dhe shërbime".

Gjithashtu, në pikën 4 të këtij neni, parashikohet se:

"Fondet publike" janë:


- a) *çdo vlerë monetare e Buxhetit të Shtetit, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;*
- b) ***çdo vlerë monetare e buxhetit vendor, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;***
- c) *fonde ndihme ose kredi, të dhëna nga donatorë të huaj, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën kërkohet zbatimi i procedurave të këtij ligji;*
- ç) *të ardhura nga shteti, ndërmarrjet lokale, shoqëritë tregtare dhe entet e tjera, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve ose të kapitalit".*


Në kuptim të dispozitave të sipërcituara, autoriteti kontraktor ndërmerr një procedurë të caktuar prokurimi, në rastet e përzgjedhjes së operatorit ekonomik fitues, për realizimin e objektit të prokurimit (mall/punë/shërbim), bazuar në vlerën përkatëse (buxhetit vendor në rastin konkret), të përcaktuar për prokurim.

Duke qenë se, në shkresën tuaj parashtrohet se pagesa do të kryhet nga qytetarët dhe jo, nga buxheti i Bashkisë (buxheti vendor), nuk kemi të bëjmë me përdorim të fondit publik në kuptim të përcaktimit ligjor në dispozitën e sipërcituar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM





BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA TIRANË
KRYETARI

Nr. 228/prot.

Tiranë, më 11.10.2018

Lënda: Dhënie opinionimi ligjor.

ZONJËS REIDA KASHTA
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

E nderuar zonja drejtoreshë e përgjithshme,

Bashkia Tiranë, në kuadër të ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësi të saj në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, ka përcaktuar Tirana Parking si strukturën përgjegjëse për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë.

Aktualisht vjelja e tarifës së parkimit kryhet me anë të biletës fizike dhe platformës SMS payment, por gjatë veprimtarisë së përditshme, pavarësisht efikasitetit të këtyre metodave është konstatuar se në shumë raste ka pasur ankesa në lidhje me mënyrën e pagesës për shkak se shumë qytetarëve nuk kanë pasur vlera të mjaftueshme financiare në numrin e tyre celular për kryerjen e kësaj pagese apo dhe qytetarët e huaj që përdorin parkimin publik me pagesë nuk mund të përfitojnë nga ky shërbim për shkak se nuk disponojnë një numër telefoni të një kompanie shqiptare. Mungesa e një mjeti opsioni tjetër alternativ për kryerjen e pagesës së parkimit publik në qytetin e Tiranës, ka sjellë vështirësi në arkëtimin e tarifave të parkimit.

Për këtë qëllim, për një menaxhim sa më efikas të vjeljes së të ardhurave, Bashkia Tiranë po shqyrton mundësinë e shtimit të një metode tjetër alternative, e cila konsiston në vendosjen e pajisjeve vetëshërbyese në vendet e destinuara për parkim, të cilat mund të punojnë gjatë periudhës kur shërbimi i parkimit është aktiv dhe që përbën një metodë të thjeshtë dhe efektive për verifikimin e kryerjes së pagesave nga struktura përgjegjëse e Bashkisë Tiranë.

Për sa më sipër, një ndër shoqëritë që operojnë aktualisht në tregun vendas në fushën e shërbimit të pagesave duke përdorur pajisje elektronike, ka shprehur interesin për ofrimin e këtij shërbimi alternativ pagese. Kjo shoqëri përdor pajisje elektronike, të cilat iu mundësojnë klientëve të kryejnë pagesa të shërbimeve të ndryshme (pagesa të faturave të OSHEE, UKT, telefoni, televizion, etj) me para në dorë (cash) pa qenë nevoja të përdorin pajisje të tjera elektronike.

Kjo shoqëri merr përsipër të mundësojë infrastrukturën e nevojshme dhe t'u ofrojë qytetarëve dhe përdoruesve të shërbimit publik të parkimit të ofruar nga Tirana Parking, mundësinë e pagesës së tarifës së shërbimit të parkimit publik në qytetin e Tiranës nëpërmjet pajisjeve vetëshërbyese të vendosura në zonat e destinuara për parkim sipas

parashikimeve me anë të një marrëveshje. Për realizimin e këtij shërbimi, shoqëria që ka shprehur interesin, e ofron këtë shërbim kundrejt mbajtjes së një komisioni shërbimi, nga pagesa që kryhet nga qytetarët që përfitojnë nga shërbimi i parkimit publik.

Sa më lart, në kuadër të bashkëpunimit institucional, kërkojmë nga ana juaj dhënien e opinionit nëse ky shërbim duhet të jetë objekt i zbatimit të procedurave të prokurimit publik, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

KRYETARI

Erion VELIAJ

